



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO

Ministria e Drejtësisë / Ministry of Justice

03-3576/12

08-10-2012

DPK/DMP

02



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË DEÇAN/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
DEČANIMA/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN DEÇAN

Rag.Nr.2434 / 2012

Gjykata komunale për kundërvajtje në Deçan ,me gjyqtarin Nexhat Musaj dhe sekretaren juridike Hasime Qorraj , duke vendosur në procedurën kundërvajtëse ndaj te pandehurit Luan Rexhë Kuçi nga Juniku , për shkak të kundërvajtjes nga neni 17 paragrafi 1.3 te Ligjit për Deklarimin ,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin ,Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për te Gjithë Personat Zyrtarë e në veshtrim me dispozitat e nenit 30,123 dhe 195 të Ligjit mbi Kundërvajtjet me dt.25.09.2012 bje këtë:

A K T V E N D I M

I Pandehuri , Luan Rexhë Kuçi I lindur 04.05.1976 ne Junik ,ku edhe tani banon dhe jeton , me profesion mjek , Drejtor për Shendetësi dhe Mirqenje Sociale ne Junik , me gjendje te mesme ekonomike I pa denuar gjerë me tani .

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S

Për shkakë se : Nuk e ka deklaruar prejardhjen dhe Kontrollin e pasurisë te Zyrtarit te Lartë Publik për vitin 2011 ne Agjencionin Kundër Korrupsion ne Prishtinë , pas marrjes se detyres zyrtare edhe pse ka qenë I detyruar qe ta deklaroj pasurinë deri me daten 31.03.2012 .

-me një veprim te tillë ka bërë kundërvajtje nga neni 17 paragrafi 1.3 te Ligjit për Deklarimin ,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin ,Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për te Gjithë Personat Zyrtarë , e në bazë te se njejtave dispozita .

G J O B I T E T

Me denim gjobe në shumë prej 1500 (njëmijepesqindë) Euro.

Denimin e shqiptuar ka për ta përmbuar në afat prej 15 ditesh pasi qe aktevendimi e merrë formen e prerë ,pagesa bëhet nëpërmes kesaj gjykate.

Nese denimin e shqiptuar nuk e permbaron në afatin e paraparë ligjor atëhere denimi I shqiptuar do te shendrrohet në denim burgimi në kohezgjatje prej 30 ditesh duke ju llogaritur ditën e burgut ne 15 Euro

Obligohet qe në emer te paushallit gjyqesor te paguaj shumen e te hollave prej 10 Euro

ARSYETIM

REPUBLIKA E KOSOVES-AGJENCIA KUNDËR KORRUPSION – PRISHTINË ka parashruar kërkesen me nr. 01-2341/12 te dt.02.07.2012 qe ndaj te pandehurit te zhvillohet procedura kundërvajtëse te shpallet fajtor dhe te denohet në bazë te Ligjit.

Në procedurën kundërvajtëse është proceduar I pandehuri Luan Kuçi I cili ne mbrojtjen e vet ka deklaruar : Lidhur me kundërvajtjen per te cilen me ngarkon Agjësia Kunder Kurrupcionit ne Prishtinë : kam per te deklaruar se per vitin 2011 unë nuk e kam deklaruar pasurinë ne Agjensionin Kosovar kunder kurrupcionit per vitin 2011,sepse poziten e Drejtorit te Drejtoratit te Shendetësisë ne Komunen e Junikut , e kamë ushtruar deri ne muajin janar te vitit 2012 .

Unë faktikisht nuk e kamë ditur se jamë e obliguar qe ta deklaroj pasurinë për vitin 2011 sepse ju kamë referuar Ligjit Nr. 03/L-151 ku nuk parashihet ne nenin 1.pika 1 nenë 10 qe Drejtoret e Drejtorateve nuk janë te obliguar qe ta deklarojnë pasurinë por vetem Kryetari dhe nenkryetaret e Komunave ,kryesuesit dhe Zevendes Kryesuesit e Kuvendeve Komunale

Ndersa për Ligjin e ri Nr. 04/L-050 nuk e kamë ditur qe ekziston ky Ligj,

Ipropozoj gjykates qe ti këtë parsyshë keto rrethana

Andaj gjykata duke u bazuar në kërkesen e organit ,deklaraten e te pandehurit dhe shkresat e tjera te lendes gjeti se me te vertetë dhe në menyre te pa dyshimt i pandehuri ka bërë kundërvajtje nga 17 paragrafi 1.3 te Ligjit për Deklarimin ,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin ,Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për te Gjithë Personat Zyrtarë dhe i shqiptoj denim gjobe në shumë prej 1500 Euro duke shpresuar se edhe me një denim te tillë do te arrihet efekti i ndeshkimit qe në te ardhmen mos te perserit kundërvajtje te tilla.

Me rastin e shqiptimit te ketij denimi gjykata ka marrë për bazë menyren e kryerjes se kundërvajtjes,shkallen e pergjegjesisë ,pasojat e saj dhe gjendjen ekonomike te tij.

Me sa u cek me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me nga nji kopje të këtij aktvendimi njoftohet ushtruesi I kërkeses dhe I pandehuri .

Kundër ketij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afatë prej 8 ditesh pas marrjes se këtij aktvendimi.Ankesa ushtrohet e pataksuar për Gjykatën e Lartë për kundërvajtje në Prishtinë,

U vendos në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje ne Deçan me dt.25.09.2012 Regj.Nr. 2434/12

